



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.332, datë 20.10.2023

PËR

“REFUZIMIN E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL, ME KËRKESË PËR
VLERËSIM TË PËRSHPEJTUAR ,PËR PROKURORET
ERIDA VISOÇI DHE RISELDA FISHTA”

I. Rrethanat e faktit

Me vendimin Nr.285, datë 17.07.2023, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka shpallur 2 (dy) vende vakante për t’u plotësuar me procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në këtë procedurë, kanë aplikuar edhe kandidatet Erida Visoçi dhe Riselda Fishta, të cilat janë kualifikuar pas plotësimit të kriterëve ligjore, me Vendimin e KLP-së Nr.294, datë 19.09.2023 “Për verifikimin e kandidatëve për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele”.

Në kuadër të kësaj procedure, prokuroret Erida Visoçi dhe Riselda Fishta, kanë paraqitur respektivisht më 27.09.2023 dhe 28.09.2023, kërkesat për vlerësim të përshpejtuar në bazë të parashikimeve të nenit 97 të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Në kërkesat e paraqitura, prokuroret Erida Visoçi dhe Riselda Fishta përmendin faktin se, KLP-ja në mbledhjen plenare të datë 19.09.2023, ka pranuar të kryejë vlerësim të përshpejtuar edhe për magjistratë të tjerë.

Bazuar në nenit 97, pika 1 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenit 35, pika 2 të Rregullores “Për vlerësimin Etik dhe profesional të Prokurorëve”, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale (në vijim KVVEP) mbart detyrimin ligjor të kryejë vlerësimin etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar me kërkesë të prokurorit në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji për aq sa është e mundur.

Nga Sektori i Burimeve Njerëzore pranë KLP-së konfirmohet se:

1. Për prokuroren **Erida Visoçi** - nuk ka asnjë vlerësim në dosje, sepse është prokurore e re e emëruar në datë 12.07.2019.

2. Për prokuroren **Riselda Fishta** rezultojnë vlerësimet profesionale si më poshtë:

- viti 2012 – Mirë
- viti 2013 – Mjaftueshëm
- viti 2014 – Mjaftueshëm
- viti 2015 – Mirë
- viti 2016 – Mirë.

Ndërkohë, për zonjën Erida Visoçi rezulton se, kjo prokurore është magjistrate e re dhe nuk ka asnjë vlerësim dhe nisur nga ky fakt, KLP-ja e ka përfshirë këtë prokurore në programin e vlerësimit etik dhe profesional të miratuar për vitin 2023, dhe me Vendimin Nr.58, datë 06.03.2023, ka vendosur caktimin me short të relatorit dhe këshilltarit ligjor përgjegjës për procedurën e vlerësimit etik dhe profesional individual.

Në kuadër të këtij procesi, pas vënies në dispozicion të Këshillit të gjithë dokumentacionit dhe informacionit të nevojshëm sipas Aneksit Nr.2 të Rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, në datë 25 Shtator 2023, është hedhur shorti për përzgjedhjen dosjeve të prokurores Erida Visoçi, që do të vlerësohen nga ana e KVVVEP-së.

Komisioni pasi ka marrë në shqyrtim kërkesat e paraqitura nga prokuroret Erida Visoçi dhe Riselda Fishta për vlerësim të përshpejtuar, me shumicë votash, ka vendosur që me Relacionin Nr.2400 prot., datë 18.10.2023, t’i propozojë Këshillit pranimin e këtyre kërkesave, për arsyet e mëposhtme:

1. Plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 97 i ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe neni 11, pika 5 e rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Konkretisht:

- prokuroret kandidojnë për t’u transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - kanë ushtruar detyrën përgjatë gjithë vitit të fundit kalendarik;
 - nuk janë vlerësuar për dy vitet e fundit kalendarike.
2. Bazuar në parimin e funksionalitetit dhe të barazisë, kryerja e vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar për këto prokurore është i realizueshëm, pasi procedura e vlerësimit të përshpejtuar përfshin vitin e fundit kalendarik, konkretisht periudhën nga data 1 Janar 2022-31 Dhjetor 2022.
 3. Vlerësimi i përshpejtuar për prokuroren Erida Visoçi përfundon më shpejt se procedura standarde e vlerësimit etik profesional individual (2019-2021).

II. Vlerësimi i Këshillit

Prokuroret Erida Visoçi dhe Riselda Fishta, kandidatë në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kanë paraqitur respektivisht më datë 27.09.2023 dhe 28.09.2023, kërkesat për vlerësim të përshpejtuar në bazë të parashikimeve të nenit 97 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Në nenit 11, pika 3, e Rregullores "Per proceduren e levizjes paralele te prokuroreve" parashikohet se:



[..] "Kandidati ka të drejtë që, në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, të kërkojë kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar, sipas parashikimeve të nenit 97 të Ligjit për Statusin dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij". [..]

Rregullorja e miratuar parashikon në mënyrë të qartë momentin se kur paraqitet kërkesa për vlerësim të përshpejtuar dhe, ky moment është pikërisht momenti i kandidimit.

Në kërkesat e adresuara nga prokuroret Erida Visoçi dhe Riselda Fishta citohet se, këto prokurore janë njohur me faktin se edhe për magjistratë të tjerë, kandidatë në këtë procedurë, është pranuar kryerja e vlerësimit të përshpejtuar me kërkesë.

Ndërkohë, rezulton se të dyja prokuroret për të cilat u pranua kërkesa për vlerësim të përshpejtuar, Vitjuna Mata dhe Blerta Hamza me Vendimet respektive të KLP-së Nr.306, datë 19.09.2023 dhe Nr.307, datë 19.09.2023, i kishin paraqitur kërkesat e tyre gjatë afatit të përcaktuar për aplikim në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për plotësimin e dy vendeve vakante në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Konkretisht, afati i përcaktuar për aplikim në shpalljen e KLP, ka qenë data 01.09.2023, ora 24:00. Prokuroret Blerta Hamza dhe Vitjuna Mata kanë dërguar kërkesën për vlerësim të përshpejtuar respektivisht në datë 31.07.2023 dhe datë 09.08.2023, pra, brenda periudhës së kandidimit.

Ndërsa, në rastin e prokuroreve Erida Visoçi dhe Riselda Fishta, kërkesat e tyre për vlerësim të përshpejtuar në kuadër të procedurës për lëvizjen paralele nuk janë paraqitur në momentin e kandidimit, por pas mbylljes së fazës së aplikimit (rreth një muaj më vonë), dhe pas fazës së verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore të kandidatëve.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli vlerëson se, kërkesat e kandidatëve për vlerësim të përshpejtuar nuk mund të paraqiten në çdo kohë dhe në çdo fazë të procedurës së lëvizjes paralele por, sikurse parashikohet në Rregulloren "Për procedurën e lëvizjes paralele të prokurorëve", këto kërkesa lidhen ngushtësisht me "momentin e kandidimit" dhe, momenti i kandidimit është pikërisht momenti kur çdo i interesuar për të marrë pjesë në garë shpreh interesin dhe paraqet kërkesën për aplikim.

Nga ana tjetër, sikurse është përmendur edhe nga anëtarët e Komisionit, prokurorja Erida Visoçi është përfshirë në programin e vlerësimit etik dhe profesional të miratuar për vitin 2023, dhe me vendimin Nr.58, datë 06.03.2023, KLP-ja ka vendosur caktimin me short të relatorit dhe këshilltarit ligjor përgjegjës për procedurën e vlerësimit etik dhe profesional individual.

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për këtë prokurore ka avancuar dhe aktualisht rezulton në datë 25 Shtator 2023, është hedhur shorti për përzgjedhjen dosjeve të saj, që do të vlerësohen nga ana e KVVEP.

Pra, procesi i vlerësimit etik dhe profesional i nisur për prokuroren Erida Visoçi përfundon më shpejt se procesi i vlerësimit të përshpejtuar, pasi kjo e fundit, referuar parashikimeve të nenit 36

te Rregullores "Per vleresimin etik dhe profesional te prokuroreve", parashikon rregulla te veçanta sa i takon afateve ligjore dhe hapave që duhet të ndiqen për realizimin e kësaj procedure.

Në rast të respektimit me rigorozitet të gjithë afateve të përcaktuara në Rregulloren e vlerësimit, procedura e vlerësimit të përshpejtuar parashikohet të zgjasë rreth 3 muaj e gjysmë, ndërsa sipas përcaktimeve në nenin 32 dhe nenin 33 të kësaj Rregulloreje afati kohor për përfundimin e projektraportit të vlerësimit është rreth 2 (dy) muaj.

Ndërkohë, për zonjën Riselda Fishta, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë rezulton se, me vendimin Nr.4 datë 14.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit kjo prokurore është pezulluar nga detyra për një periudhë një vjeçare me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Prokurorja Riselda Fishta është rikthyer në detyrë më datë 14.07.2022, dhe kësisoj nuk mund të vlerësohet për këtë vit kalendarik, sikurse përcaktohet në nenin 97, pika 2 të ligjit Nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Në përfundim, bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa "a" të Kushtetutës, nenet 159, pika 2, germa "a", 164 pika 8, 189 pika 1, të ligjit Nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, nenin 97 të ligjit Nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe në nenin 35 të Rregullores "Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Refuzimin e vlerësimit etik dhe profesional me kërkesë për vlerësim të përshpejtuar për prokuroret, Erida Visoçi dhe Riselda Fishta.
2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet prokurorëve Erida Visoçi dhe Riselda Fishta.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, më 20.10.2023.



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Elaida Coxhi

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ANËTAR
Bujar Sheshi


ANËTAR
Esmeralda Keshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda
(kundër)

ANËTAR
Mirela Bogdani
(kundër)



ANËTAR
Arta Mandro
(kundër)



ANËTAR
Ledina Riza
(kundër)

